



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Legjislatura e III-të

Nr. 22/09

Prishtinë, më 20.05.2009, ora 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Zylfi Merxha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: Armin Rieser nga Ambasada Zviceriane, moniturues nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante) dhe Gazmend Avdyli (praktikant).

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 29.04.2009;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për Lizingun Financiar nr. 03/L-103, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;**

6. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 03 –P – 102 me dt. 05.05.2009;

7. Të ndryshme.

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, njoftoi se në mbledhje kemi të pranishëm përfaqësuesin nga Ambasada Zviceriane, i cili do të njoftoj rreth vizitës për në Zvicër. Propozoi që rendi ditës të plotësohet.

Rendi i ditës miratohet me plotësim. Shtohet një pikë e re si pika e dytë: Diskutim lidhur me vizitën në Zvicër. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit ditës.

2. Diskutim lidhur me vizitën studimore dhe të punës së komisionit në Zvicër

Kryesuesi, falënderoj përfaqësuesin nga Ambasada Zviceriane për praninë e tij dhe gatishmërinë për të ndihmuar për realizimin e vizitës në Zvicër. Për më tepër rreth kësaj teme ia dha fjalën atij.

Armin Rieser, njoftoi se qëllimi i pranisë së tij në komision është marrje e informacioneve, sugjerimeve apo propozime lidhur me vizitën që pritet të realizohet në Zvicër. Z. Rieser kërkoi që komisioni të dal me propozime konkrete për përgatitjen e programit, në mënyrë që vizita të karakter edhe pune. Theksoi se programi parasheh takim me institucione në nivelin federal dhe të kantoneve. Prandaj në këtë drejtim komisioni të propozoj temat që do të diskutohen.

Sadik Idriz, propozoi që komisioni paraprakisht të monitorojë ligjet që kanë të bëjnë me komunitetet, të identifikoj problemet si psh. rasti i përdorimit të gjuhëve apo decentralizimi, dhe mëpastaj të dal me propozime dhe sugjerime konkrete, që të mundet të përgatitet tematika e vizitës, dhe që ajo mos të ketë vetëm karakter studimor por edhe pune.

Enis Kervan, theksoi se komuniteti turk ka problem në zbatimin e gjuhës turke në nivelin lokal edhe pse ajo me statutin e komunave është e garantuar si gjuhë zyrtare. Prandaj duke qenë në dijeni se Zvicra është shembull i bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve dhe përdorimit të shumëgjuhësisë, shprehu dëshirën për realizimin e një vizite të këtillë, për të parë përvojat e mira që ka ky shtet dhe të njëjtat të sjellën për zbatim në Kosovë.

Sanije Aliaj, përkrahu propozimet e z. Idriz, që komisioni të marrë informacione për zbatimin e ligjeve në nivelin qendror dhe lokal, dhe në bazë të saj të renditen temat që do të diskutohen në vizitën në Zvicër, në mënyrë që vizita të mos ketë vetëm karakter studimor por edhe pune. Të mundohemi që përvojat nga kjo vizitë në këtë shtet demokratik, ti sjellim për zbatim në Kosovë.

Xhevdet Neziraj, gjithashtu mbështeti propozimet që komisioni të konsultohet paraprakisht, dhe të propozoj temat që do të mund të diskutoheshin gjatë vizitës në Zvicër.

Numan Balic, vizita do të ketë karakter të mirë për të parë përvojat e shtetit zviceran, në respektimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe të njëjtat përvoja të mundohemi t'i bartim në Kosovë, për të tejkaluar problemet që ekzistojnë.

Kryesuesi, u pajtua me propozimet për krijimin e grupit punues për të përgatitur vizitën. Së bashku me përfaqësuesin e Ambasadës Zvicerane dhe me ndihmën e OSBE-së, të hartohet një program i

punës që vizita të jetë e suksesshme. Të shikohen përvojat dhe mundësinë e implementimit të tyre në Kosovë.

3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 29.04.2009

Xhevdet Neziraj, theksoi se në pikën e katërt të rendit të ditës, në diskutimin e tij është keqinterpretuar. Nuk ka thënë të monitorohet Ligji për Ndërmarrjet Publike, por Ligji për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve Komunitete, që të shihet se sa janë të punësuar komunitetet joshumicë në këto ndërmarrje dhe në institucionet tjera publike dhe shtetërore. Kërkojë të bëhen këto korrigjime.

Enis Kervan, theksoi se në diskutimet e tij nuk është përfshirë gjithë ajo që ka thënë. Ai ka folur në gjuhën shqipe me qëllim që të kuptohet më lehtë, por megjithatë mendimet e tija nuk janë përfshirë.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 29.05.2009, u miratua me vërejtjet e bëra.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Lizingun Financiar nr. 03/L-103, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Lizingun Financiar nr. 03/L-103 dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 03/P -102 me dt. 05.05.2009

Kryesuesi, njoftoi me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, me të cilin ngarkohet komisioni ynë që të monitoroj Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dhe të hartoj raportin për Kuvendin. Përfundimi është nxjerrur pas mocionit të nënshkruar nga gjashtë deputet, pjesë e së cilëve është edhe anëtari i komisionit, z. Numan Balić. Prandaj theksoi se duhet të formojmë një grup punues, i cili do të punojë në këtë drejtim.

Numan Balić, theksoi se qëllimi i kërkesës drejtuar Kryesisë së Kuvendit ka qenë që në Kuvend të debatohet për respektimin e ligjeve dhe të drejtave të komuniteteve. Kryesia me Përfundimin e nxjerrur ka obliguar komisionin që të monitoroj dy ligje, e që në fakt kemi më shumë ligje që nuk zbatohen dhe nuk respektohen të drejtat e komuniteteve. Me këtë akt Kryesia ka shkelur rregulloren e punës. Prandaj kërkoj që komisioni të nxjerr një rekomandim për Kryesinë për shkeljen e rregullores së punës. Njëkohësisht të kërkohet që në seancën plenare të formohet një grup i cili brenda afatit prej 15 ditësh harton raportin për Kuvendin lidhur me zbatimin e Ligjeve në drejtim të respektimit të të drejtave të komuniteteve.

Sadik Idriz, duke u ndërlidhur me temën, theksoi se nuk është e nevojshme të kërkojmë sqarime nga Kryesia lidhur me Përfundimin. Komisioni duhet të krijoj grupin punues për të bërë monitorimin e ligjeve përkatëse, dhe pastaj të hartoj raportin për komisionin dhe Kuvendin. Kjo do të plotësonte kushtet, që çështja për temën e caktuar të futej në rend dite për debat në seancë plenare.

Sanije Aliaj, mbështeti propozimin për krijimin e grupit punues për monitorimin e ligjeve përkatëse. Të realizohen vizitat në nivelin qendror dhe lokal, dhe mëpastaj të hartohet raporti me rekomandime për Kuvendin, duke indentifikuar ligjin i cili nuk po zbatohet.

Kosara Nikolić, theksoi se ka shkelje të ligjeve për të drejtat e komuniteteve dhe moszbatim të ligjeve. Në këtë drejtim nëse nuk ndërmerret diçka, kjo nuk është në të mirë as të Kuvendit dhe as të

shoqërisë. Prandaj u pajtua me propozimin për formimin e grupit punues i cili duhet që brenda afatit të paraqes raportin e monitorimit.

Enis Kervan, pashëndeti Përfundimin e Kryesisë. Theksoi se si komision të realizojmë vizitat në të gjitha pjesët e Kosovës për të parë shkeljen e të drejtave të komuniteteve dhe mosrespektimin e ligjeve. Problemet ekzistojnë jo vetëm me përdorimin gjuhëve por edhe librat të cilat nuk po shtypen falas për komunitetet jo shumicë, gjë që tregon se shumë ligje nuk po zbatohen. Pas realizimit të vizitave të hartojmë një raport të mirëfilltë për Kuvendin, që deputetët të mund të njoftohen për problemet në këtë fushë.

Xhevdet Neziraj, gjithashtu u pajtua me propozimin për krijimin e grupit punues, i cili do të realizojë vizitat me qëllim të monitorimit të ligjeve dhe më pas të hartoj raportin me rekomandime të qarta për Kuvendin, me të cilin tregohet se sa dhe si po zbatohen ligjet në praktikë. Të evidentohen të gjeturat, dhe të rekomandohet në përmisimin e tyre. Të gjithë jemi të interesuar që ligjet të imlementohen në dobi të të gjitha komuniteteve. Në këtë drejtim është interes i shtetit të Kosovës që garantojë këto të drejta, që mos të jenë pengesë në integrimet evropiane.

Kryesuesi, theksoi se në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, Kryesia mund të kërkoj nga komisionet të monitorojnë ligjet. Prandaj nga kjo shifet se Përfundimi ka bazën ligjore. Kërkoj që si komision të tregohemi unik dhe të krijojmë grupin punues i cili do të monitoroj zbatimin e ligjeve dhe të hartoj raportin me rekomandime, të cilin do ta shqyrtoj komisioni dhe më pas do ta procedoj në Kuvend.

Numan Balić, theksoi se çështjet për respektimin e të drejtave të komunitete do të duhej të diskutohej nga Kuvendi në mënyrë periodike. Përndryshe u paraqit si vullnetar për të kryesuar grupin punues për monitorimin e ligjeve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Krijohet grupi punues i cili do të bëjë monitorimin e Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe do të hartoj raportin me rekomandime për shqyrtim në Komisionin dhe Kuvendin.

Anëtarë të grupit punues janë: **Numan Balic (kryesues), Kosara Nikolic, Hafize Hajdini, Sanije Aliaj, Mufera Sinik, Xhevdet Neziraj dhe Murselj Haljilji.**

7. Të ndryshme

Kryesuesi, duke parë kushtet e vështira për punë, theksoi se do të shkruhet një kërkesë me vërejtje personave përgjegjës të administratës, që të krijohen kushtet teknike për mbajtjen e mbledhjeve të komisionit. Kërkesa u përkrah njëzëri.

Kryesuesi, njoftoi se në bashkëpunim me OSBE-në do të organizohet një tryezë e rumbullakët, ku do të ftohen përfaqësuesit e komuniteteve në nivelin lokal, në të cilën temë diskutimi do të jetë: Implemtimi i ligjeve në fushën e të drejtave të komuniteteve.

Në të ndryshe kryesuesi kërkoj që të krijohet edhe një grup punues i cili do të analizojë planin e veprimtimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, të

identifikoj veprimet e komisionit që dalin nga ky plan dhe të diskutohet në komision. Njëkohësisht ky grup do të ketë për obligim të kontaktoj me përfaqësuesit e Ambasadës Zviceriane për të përgatitur vizitën në Zvicër.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Krijohet grupi punues i cili do të analizoj planin e veprimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit të komisionit evropian për vitin 2008 dhe do të identifikoj veprimet e komisionit që dalin nga ky plan, të cilat do të diskutohen në komision.
- II. Përgatitja e agjendes për tryezen e rumbullaket
- III. Grupi punues në bashkëpunim me Ambasadën Zvicerane do të përgatit agjendën për vizitën që do të bëhet në Zvicër.

Anëtarë të grupit punues janë: **Sanije Aliaj, Bojan Stojanović, dhe Hetem Arifi dhe Enis Kervan.**

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ